



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1786/1 Prot.

Tiranë, më 26.12.2019

V E N D I M

Nr.202 dt. 26.12.2019

***“Mbi zgjatjen e marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil, për nëpunësen
***** deri në përfundim të procedurës së konkurrimit, për zëvendësimin e saj”.***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të hetimit administrativ mbi gjendjen e marrëdhënieve në shërbimin civil, të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2018”, ku shprehimisht është kërkuar: “Të shqyrtohen me prioritet rastet e individëve, pjesë e shërbimit civil në administratën qendrore dhe vendore, të cilët vazhdojnë marrëdhëniet e punës, megjithëse kanë arritur moshën e pensionit dhe duhet të kishin ndërprerë në kohë marrëdhëniet juridike dhe financiare”, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Për kryerjen e kësaj detyre, është kërkuar informacion nga njësitë e burimeve njerëzore në institucionet e përfshira në këtë proces, në lidhje me ata nëpunës, të cilët megjithëse kanë plotësuar moshën e pensionit të pleqërisë, ende vazhdojnë marrëdhënien e punës në pozicione të shërbimit civil.

Në këtë proces është përfshirë edhe institucioni i Shërbimit Social Shtetëror, institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucion i cili punëson

nëpunës civilë. Në të njëjtën kohë, Departamenti i Administratës Publike, në rolin e njësisë përgjegjëse, nëpërmjet shkresës nr. 7147/1 prot., datë 13.12.2019, (e protokolluar pranë Komisionerit, me shkresën nr. 1765 prot., datë 17.12.2019), ka vënë në dijeni këtë të fundit se, nëpunësja ***** me detyrë “Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm/ Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, megjithëse ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë, vazhdon të jetë në marrëdhënie me shërbimin civil, gjë e cila vjen në kundërshtim me pikën 1/c të nenit 65 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, kur plotësohet mosha për pension të plotë të pleqërisë dhe pozicioni që mbetet vakant duhet të plotësohet sipas procedurës së parashikuar prej neneve 21, 22 e 23 të ligjit në fjalë.

Ndodhur në kushtet e mësipërme, institucioni i Shërbimit Social Shtetëror përmes shkresës së tij me nr. 1911/2 prot., datë 23.12.2019, me objekt: “Mbi vazhdimësinë e marrëdhënies së punës së *****”, (protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1786 prot., datë 24.12.2019), ka argumentuar nevojën e vazhdimit të përkohshëm të marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësen ***** duke argumentuar se punonjësja në fjalë, për shkak të funksionit ushtron autoritet të drejtpërdrejt publik, për formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre.

Gjithashtu, për shkak të qënies me lejen e lindjes së titullarit të institucionit, ajo herë pas here ushtron edhe detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm në SHSSH, funksion të cilin e mbulon për shkak të orarit të reduktuar të punës së këtij të fundit, gjatë vitit të parë të lindjes, bazuar në nenin 105, pika 3, e Kodit të Punës dhe nenin 5, pika 3, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 634, datë 15.07.2015.

Në të njëjtën kohë, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 136, datë 07.03.2018, “Për funksionimin dhe administrimin e regjistrit elektronik kombëtar të shërbimeve të kujdesit shoqëror”, shërbimet e kujdesit shoqëror janë përfshirë në një reformë të rëndësishme të funksionimit dhe administrimit të regjistrit elektronik kombëtar, proces për të cilin nëpunësja ***** ka marrë trajnimet e nevojshme profesionale për ndjekjen dhe menaxhimin e tij.

Vlen të përmendet se, për shkak të situatës së rëndë që kaloi vendi si pasojë e tërmetit, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, në institucionin e Shërbimit Social Shtetëror, nën drejtimin e nëpunëses në fjalë, ka qenë gjithnjë në terren në ndihmë të qytetarëve në disa qytete.

Në analizë të sa më lart arrij në përfundimin se, ndërprerja e menjëhershme e marrëdhënies së punës në shërbimin civil për nëpunësen ***** do të sillte pengesë për ecurinë normale të punës në institucionin Shërbimi Social Shtetëror, prandaj vlerësoj se kërkesa për shtyrjen e afatit të ndërprerjes së marrëdhënies së saj në shërbimin civil, deri në plotësimin e pozicionit nëpërmjet procedurës së konkurrimit është e drejtë dhe si e tillë duhet pranuar.

Për të gjitha sa u tha më sipër, bazuar në nenin 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe pikës 9, të nenit 16, të rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015,

V E N D O S A:

1. Të miratoj vazhdimin e marrëdhënies në shërbimin civil për nëpunësen *****, me detyrë “Zëvendës drejtor i Përgjithshëm/ Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Sociale”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, deri në përfundimin e procedurave ligjore për zëvendësimin nëpërmjet konkurrimit dhe emërimit nga ana e Departamentit të Administratës Publike, të nëpunësit tjetër civil në këtë pozicion.
2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Shërbimit Social Shtetëror, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Departamenti i Administratës Publike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha